




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



Data: 20.09.2019

Rahovec

-III- Nr. i prot. 2922 Më 20.09.19
Br. prot. Dt. 20.09.19
RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PËR APLIKIM

Njoftohen fermerët e komunës së Rahovecit se Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2019, ka paraparë që të bëjë ndërtimin e Serrave me participim për kultivuesit e perimeve.

Të drejtën për aplikim e kanë të gjithë fermerët e komunës së Rahovecit që i përmbushin kriteret e parapara si:

- Të jetë (fermer ose fermere) – kultivues i perimeve (i regjistruar ne programin EFR),
- Të jetë i gatshëm - e gatshme të nënshkruaj marrëveshjen me kushtet e përcaktuara nga Komuna e Rahovecit.
- Të jetë i gatshëm të kryej participimin prej 20%
- Përfituesit e viteve të kaluara do të jenë të ranguar në shkallën e dytë.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Lista poseduese e tokës - certifikata e pronësisë,
- Kopja e planit të parcelës ku do të vendoset Serra,
- Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës,
- Dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë.

Përzgjedhjen do ta bëjë komisioni i formuar pas mbylljes së afatit të aplikimit dhe do të formohet nga Kryetari i Komunës së Rahovecit,

Karakteristikat e përgjithshme për Serra:

1. Serra **300m²**, me konstruksion të çelikut të zinkuar, me dimensione: **8m x 37.5m x 4.20 m**
2. Serra **500m²**, me konstruksion të çelikut të zinkuar, me dimensione: **12m x 42m x 4.20 m**
3. Serra **700m²**, me konstruksion të çelikut të zinkuar me dimensione: **18m x 39m x 4.20 m**
4. Serra **1,000m²** me konstruksion të çelikut të zinkuar me dimensione: **24m x 42m x 4.20 m**

Participimi i fermerëve përfitues të Serrave do të bëhet duke bërë pagesën e **20%** të vlerës së përgjithshme të serës në llogari të Komunës së Rahovecit, ndërsa pjesa tjetër e vlerës apo **80%** nga shuma e përgjithshme financohet nga Komuna e Rahovecit.

Informatat dhe data e Aplikimit

Aplikimin fermerët mund ta bëjnë në zyrat e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural. Afati i aplikimit fillon prej datës **23 shtator 2019** deri me datën **11 tetor 2019**


Drejtori për BPZHR
Berat Duraku
